



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KORÇË

Adresa: Blv. "Fan Stijan Noli" Korçë

Tel +355 (0) 243366

K Ë R K E S Ë

"Për caktimin e masës së sigurimit"

**PARA :
GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË**

Në Korçë, më datë 21.01.2016, unë Dhorina Theodhori, prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi studiova aktet e proçedimit penal nr. 66, viti 2016.

KONSTATOVA :

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë janë dërguar materialet hetimore me shkresën me nr. 145 prot, datë 19.01.2016 për veprën penale të « Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale », e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga aktet e administruara në dosjen hetimore rezulton se nga ana e strukturave policore te Sektorit per Krimin Ekonomik e Financar ne Drejtorine Vendore te Policise Korce, jane administruar te dhena, per disa transaksione te dyshimta te ardhura ne emer te shtetases M. M. B., e datëlindjes 07.07.1952, banuese ne Erseke. Nga informacionet dhe te dhenat e administruara eshte konstatuar se në datat 07.12.2015 dhe 07.01.2016, kjo shtetase ka përfituar nga Belgjika, respektivisht shumat 5 879 Euro dhe 6 992 Euro me urdhërues të tyre shoqërinë "T. B.".

Transfertat e mësipërme kanë mbërritur në bankën Alpha. Nisur nga fakti që urdhërues për transfertat ndaj kësaj shtetaseje 64 vjeçare është një kompani e huaj dhe se nga fakti se janë ndeshur shpesh herë raste të përdorimit të personave të tretë për t'u shfaqur në bankë si përfitues i

transfertave duke shmangur përfituesin e vërtete të paidentifikuar oficerët e policisë kanë vijuar verifikimin e mëtejshëm lidhur me këtë shtetas dhe familjarët e saj, verifikim nga i cili ka rezultuar se :

-Kjo shtetase ka hapur llogari në Lekë në këtë bankë më datë 09.10.2015.

-Nuk ka kryer veprime, por pas mbërritjes së transfertës së datës 07.12.2015 (të sipër cituar nga Belgjika) ka kryer konvertimin e shumës së përfituar në lekë, nga të cilat më datat 14.12.2015 dhe 31.12.2015, ka tërhequr në total shumën prej 76 600 Lekë.

-Veprimet janë kryer në degën e Bankës Alpha në qytetin e Ersekës.

-Në lidhje me transfertat e përfituara shtetasja M. B. ka deklaruar se fondet vijnë nga vajza e saj që jeton në Belgjikë.

Nga kërkimi për shtetasen e sipërpërmendur dhe familjarët e saj:

1. F. B. i datëlindjes 22.07.1943.
2. V. F. B. e datëlindjes 19.06.1983.
3. D. F. B. i datëlindjes 03.05.1972.
4. O. F. B. i datëlindjes 11.12.1978.

rezultojnë transaksione të vlerave vetëm në emër të shtetasës M. B. e cila (përveç transaksioneve të sipërcituara), më datë 10.12.2012, ka derdhur në Bankën Kombëtare Tregtare shumën prej 1 000 000 Lekë dhe e ka investuar në depozitë me afat. Nga kërkimi në burime të hapura për urdhëruesin shoqërinë "T. B." rezulton një fabrikë përpunimi litarësh në Belgjikë.

Nga kërkimi në sistemin TIMS rezultojnë hyrje dalje në pikën e kalim kufirit të Kapshticës së shtetasve D. B., M. B. dhe O. B. që nga viti 2005 e në vijim me një shpeshtësi prej 1 - 2 herë në vit.

Në lidhje me shtetasen V. B. rezultojnë hyrje dalje në pika të ndryshme të kufirit nga të cilat veçojmë se më datë 26.09.2015, ka udhëtuar nga pika e kalim kufirit të Murriqanit me një makinë me targa OBEV4444. Në të njëjtën makinë ka udhëtuar dhe shtetasi E. M. Hatija i datëlindjes 14.07.1986. Nga kërkimi në të dhënat tona për këtë shtetas nuk rezultojnë transaksione. Eshtë për tu përmendur fakti se ky shtetas në harkun kohor 2007-2009 është deportuar nga shteti grek 18 here. Nga verifikimet e mëtejshme të kryera për familjarët e shtetasit Ervin Meti Hatija, i dtl 14.07.1986, lindur në Fier dhe banues në Mbrostar-Ura, Fier, ka rezultuar se vëllai i tij Ilir Hatija, në dt. 31.10.2012 është shpallur në kërkim policor nga strukturat e Komisarariatit të Policisë Lushnje, pasi dyshohet se në dt. 29.10.2012, në fshatin Kolonje-Lushnje, në bashkëpunim dhe me persona të tjerë, kanë vjedhur me arme zjarri shtetasit I. G., E. G. dhe A. B. Në datën 11.12.2012 është hequr nga kërkimi policor për shkak të plotësimit të afatit. Në datën 21.12.2012 ky shtetas është shpallur në kërkim, pasi ndaj këtij shtetasi është marrë masa e sigurisë "arrest me burg" nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, me vendim nr. 178, dt. 18.12.2012, për veprën penale "Vjedhje me arme" në bashkëpunim të parashikuar nga neni 140-25 të Kodit Penal. Në dt. 05.11.2013, ky shtetas është ekstraduar nga Interpol

Tirana, ne Komisarjatin e Policise Rinas, ku eshte mare ne dorezim nga patrulla e Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve. Nderkohe qe vellai tjetër i shtetasit **E. M. H.**, i cili quhet **B. H.** ka qene person i denuar me pare, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlore, me vendim nr. 74, dt. 02.03.2007, e ka denuar kete shtetas me 3 muaj burg, per vepren penal te parashikuar nga neni 33/1 i K.P.Ushtarak.

Nga sa më sipër, bazuar :

-Në mungesën e dokumentacionit për justifikimin e transfertave të përfituara nga shtetasja **M. B.**

-Urdhëruesi është një shoqëri kurse nga deklaratat e saj rezulton se fondet janë nga vajza që jeton në Belgjikë.

-Ekzistenca e tipologjive ku shtetas të ndryshme përdoren për përfitime transfertash pa i shfaqur përfituesi real i shumave ka lindur një dyshim I bazuar për burimin e fondeve dhe aktivitetin e saj.

Sipas informacionit të siguruar rezulton se është vendosur bllokimin i përkohshëm i transaksioneve dhe veprimeve financiare për shtetasen **M. B.**, përkatësisht urdheri nr. 2, dt. 11.01.2016, te Drejtiorise se Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave Tirane.

Me shkresw n me nr. 2382 prot, datw 20.01.2016 "ALPHA BANK", ka vwnw nw dipozicion tw organit procedues praktikwn e celjes sw llogarisw bankare nw emwr tw shtetases **M. M. B.** me nr. AL31902445-0112203144.

Për të gjitha arsyet e parashtruara me sipër, për të garantuar ecurinë e mëtejshme të hetimeve, prokuroria vlerëson se vendosjen e masës së sigurimit pasuror e sekuestros preventive mbi llogarinë bankare të shtetasit Marika Bregu në llogarinë e saj në Bankën ALPHA është e domosdoshme pasi disponimi I lirë I llogarisë bankare të poseduar prej kësaj shtetase mund të vijojë zgjatjen e pasojave të veprën penale për të cilën është regjistruar ky procedim penal.


Për sa më sipër, duke pasur parasysh rrethanat e ngjarjes, kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 274, 275, 276 të K.Pr.Penale

K Ë R K O J :

1. Vendosjen e masës së sigurimit pasuror të "sekuestro preventive" të parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penale, ndaj llogarisë bankare të shtetases **M. M. B.** tek Alpha Bank.

Kërkesës i bashkohen edhe shkresa dhe dokumenta që i përkasin procedimit penal nr.66 të vitit 2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë.

PROKURORE E ÇËSHTJES
Dhorina THEODHORI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

K Ë R K E S Ë
PËR PUSHIMIN E ÇËSHTJES

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Në përfundim të hetimit të procedimit penal nr. 66, të vitit 2016 të filluar në datën 20.01.2017 mbi bazën e referimit të Drejtorisë Vendore të Policisë kanë rezultuar faktet si më poshtë vijon:

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë janë dërguar materialet hetimore me shkresën me nr. 145 prot, datë 19.01.2016 për veprën penale të « Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale », e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga aktet e administruara në dosjen hetimore rezulton se nga ana e strukturave policore të Sektorit për Krimin Ekonomik e Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, janë administruar të dhëna, për disa transaksione të dyshimta të ardhura në emer të shtetases ~~Marija M...~~ ~~B...~~, e datëlindjes 07.07.1952, banuese në Ersekë. Nga informacionet dhe të dhënat e administruara është konstatuar se në datat 07.12.2015 dhe 07.01.2016, kjo shtetase ka përfituar nga Belgjika, respektivisht shumat 5 879 Euro dhe 6 992 Euro me urdhërues të tyre shoqërinë "T...X B...".

Transfertat e mësipërme kanë mbërritur në bankën Alpha. Nisur nga fakti që urdhërues për transfertat ndaj kësaj shtetaseje 64 vjeçare është një kompani e huaj dhe se nga fakti se janë ndeshur shpesh herë raste të përdorimit të personave të tretë për t'u shfaqur në bankë si përfitues i transfertave duke shmangur përfituesin e vërtetë të pidentifikuar, oficerët e policisë kanë vijuar verifikimin e mëtejshëm lidhur me këtë shtetas dhe familjarët e saj, verifikim nga i cili ka rezultuar se :

-Kjo shtetase ka hapur llogari në Lekë në këtë bankë më datë 09.10.2015.

-Nuk ka kryer veprime, por pas mbërritjes së transfertës së datës 07.12.2015 (të sipër cituar nga Belgjika) ka kryer konvertimin e shumës së

përfiturar në lekë, nga të cilat më datat 14.12.2015 dhe 31.12.2015, ka tërhequr në total shumën prej 76 600 Lekë.

-Veprimet janë kryer në degën e Bankës Alpha në qytetin e Ersekës.

-Në lidhje me transfertat e përfituara shtetasja ~~Merika Bregu~~ ka deklaruar se fondet vijnë nga vajza e saj që jeton në Belgjikë. Nga kërkimi për shtetasen e sipërpërmendur dhe familjarët e saj:

1. ~~Fati Sani Bregu~~ i datëlindjes 22.07.1943.
2. ~~Vendeta Fati Bregu~~ e datëlindjes 19.06.1983.
3. ~~Dhimitri Fati Bregu~~ i datëlindjes 03.05.1972.
4. ~~Oltion Fati Bregu~~ i datëlindjes 11.12.1978.

rezultojnë transaksione të vlerave vetëm në emër të shtetasës Marika Bregu e cila (përveç transaksioneve të sipërcituara), më datë 10.12.2012, ka derdhur në Bankën Kombëtare Tregtare shumën prej 1 000 000 Lekë dhe e ka investuar në depozitë me afat. Nga kërkimi në burime të hapura për urdhëruesin shoqërinë "~~TERRA BREGU~~" rezulton një fabrikë përpunimi litarësh në Belgjikë.

Nga kërkimi në sistemin TIMS rezultojnë hyrje dalje në pikën e kalim kufirit të Kapshticës së shtetasve ~~Dhimitri~~, ~~Merika~~ dhe ~~Oltion~~ Bregu që nga viti 2005 e në vijim me një shpeshtësi prej 1 – 2 herë në vit.

Në lidhje me shtetasen ~~Vendeta Bregu~~ rezultojnë hyrje dalje në pika të ndryshme të kufirit nga të cilat veçojmë se më datë 26.09.2015, ka udhëtuar nga pika e kalim kufirit të Murriqanit me një makinë me targa OBEV4444. Në të njëjtën makinë ka udhëtuar dhe shtetasi ~~Enis Më Haxhi~~ i datëlindjes 14.07.1986. Nga kërkimi në të dhënat tona për këtë shtetas nuk rezultojnë transaksione. Eshte per tu permendur fakti se ky shtetas ne harkun kohor 2007-2009 eshte deportuar nga shteti grek 18 here. Nga verifikimet e metejshme te kryera per familjaret e shtetasit ~~Enis Më Haxhi~~, i dtl 14.07.1986, lindur ne Fier dhe banues ne Mbrostar-Ura, Fier, ka rezultuar se vellai i tij ~~Ilir Haxhi~~, ne dt. 31.10.2012 eshte shpallur ne kerkim policor nga strukturat e Komisarariatit te Policise Lushnje, pasi dyshohet se ne dt. 29.10.2012, ne fshatin Kolonje-Lushnje, ne bashkepunim dhe me persona te tjere, kane vjedhur me arme zjarri shtetasit ~~Ilir Gjermani~~, ~~Edmond Gjermani~~ dhe ~~Altan Bani~~. Në datën 11.12.2012 është hequr nga kerkimi policor per shkak të plotësimit të afatit. Ne datën 21.12.2012 ky shtetas është shpallur ne kerkim, pasi ndaj ketij shtetasi është mare masa e sigurise "arest me burg" nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Lushnje, me vendim nr. 178, dt. 18.12.2012, per vepren penale "Vjedhje me arme" ne bashkepunim te parashikuar nga neni 140-25 te Kodit Penal. Ne dt. 05.11.2013, ky shtetas është ekstraduar nga Interpol Tirana, ne Komisariatin e Policise Rinas, ku është mare ne dorezim nga patrulla e Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve. Nderkohe qe vellai tjetër i shtetasit ~~Enis Më Haxhi~~, i cili quhet ~~Blendi Haxhi~~ ka qene person i denuar me pare, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore, me vendim nr. 74, dt. 02.03.2007, e ka denuar kete shtetas me 3 muaj burg, per vepren penal te parashikuar nga neni 33/1 i K.P.Ushtarak.

Nga sa më sipër, bazuar :

-Në mungesën e dokumentacionit për justifikimin e transfertave të përfituara nga shtetasja ~~Merika Bregu~~.

-Urdhëruesi është një shoqëri kurse nga deklaratat e saj rezulton se fondet janë nga vajza që jeton në Belgjikë.

-Ekzistenca e tipologjive ku shtetas të ndryshme përdoren për përfitime transfertash pa i shfaqur përfituesi real i shumave ka lindur një dyshim I bazuar për burimin e fondeve dhe aktivitetin e saj.

Sipas informacionit të siguruar rezulton se është vendosur bllokimin i përkohshëm i transaksioneve dhe veprimeve financiare për shtetasen ~~Merrita Bregu~~, përkatësisht urdheri nr. 2, dt. 11.01.2016, te Drejtiorise se Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave Tirane.

Me shkresën me nr. 2382 prot, datë 20.01.2016 "ALPHA BANK", ka vënë në dipozicion të organit procedues praktikën e celjes së llogarisë bankare në emër të shtetasës ~~Merrita Musa Bregu~~ me nr. AL31902445774322030112203144.

Për të gjitha arsyet e parashtruara me sipër, për të garantuar ecurinë e mëtejshme të hetimeve, prokuroria ka vlerësuar në parashtrimin e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi llogarinë bankare të shtetasit ~~Merrita Bregu~~ në llogarinë e saj në Bankën ALPHA ka qënë e domosdoshme pasi disponimi I lirë I llogarisë bankare të poseduar prej kësaj shtetase mund të vijojë zgjatjen e pasojave të veprën penale për të cilën është rregjistruar ky procedim penal.

Në vijim të hetimit të kësaj çështje penale, me qëllim saktësimin e kushteve dhe rrethanave në të cilat ka ndodhur trasaksioni objekt hetimi prej organit proçedues është kërkuar ndihma juridike drejtuar autoriteteve belge të drejtësisë.

Ndihma juridike ka konsistuar në :

- Të na vihen në dispozicion kopje të akteve të rregjistrimit apo liçensimit të subjektit ~~TEMSE BUBA HOCOKAMDRSTRAT~~ 108 N/BE/9140 TEMSE, me qëllim saktësimin e objektit të aktivitetit të shoqërisë apo organizimit të sipërcituar.
- Të saktësohet informacioni nëse shtetasit ~~Merrita Musa Bregu~~, e datëlindjes 07.07.1952, ~~Ferit Seb Bregu~~, e datëlindjes 22.07.1943, ~~Vedijata Ferit Bregu~~, e datëlindjes 03.05.1972, ~~Dhimitraq Ferit Bregu~~, I datëlindjes 03.05.1972, ~~Oltion Ferit Bregu~~, e datëlindjes 11.12.1978, ~~Erasim Merit Hasija~~, I datëlindjes 14.07.1986, ~~Ili Hasija~~ kanë patur apo kanë aksione, të drejta apo detyrime në shoqërinë/subjektin ~~TEMSE BUBA HOCOKAMDRSTRAT~~ 108 N/BE/9140 TEMSE dhe nëse po të çfarë lloji dhe natyre janë ato. Te na vihen ne dispozicion kopje te akteve që dokumentojne keto marredhënie.
- Të verifikohet fakti nëse prej shtetasve ~~Merrita Musa Bregu~~, e datëlindjes 07.07.1952, ~~Ferit Seb Bregu~~, e datëlindjes 22.07.1943, ~~Vedijata Ferit Bregu~~, e datëlindjes 03.05.1972, ~~Dhimitraq Ferit Bregu~~ I datëlindjes 03.05.1972, ~~Oltion Ferit Bregu~~, e datëlindjes 11.12.1978, ~~Erasim Merit Hasija~~, I datëlindjes 14.07.1986, ~~Ili Hasija~~ janë kryer transferta në

shoqërinë ~~TEINDEK BVEA HOOGKAMBERSTRAAT~~ 108 N/BE/9140 TEMSE, dhe nëse po të na vihet në dispozicion kopje të transfertave të kryera së bashku me shkaku e kryerjes së këtyre transfertave.

- Të verifikohet fakti nëse shtetasit ~~Merika Musa Braga~~, e datëlindjes 07.07.1952, ~~Fitri Sait Braga~~, e datëlindjes 22.07.1943, ~~Vedjola Braga~~, e datëlindjes 03.05.1972, ~~Dhimitër Fati Braga~~, I datëlindjes 03.05.1972, ~~Oltija Fati Braga~~, e datëlindjes 11.12.1978, ~~Ervin Mesi Hatija~~, I datëlindjes 14.07.1986, ~~Ilir Hatija~~ kanë depozita bankare aktive apo të mbyllura në këtë shtet, apo pasuri të luajtshme apo të paluajtshme dhe nëse po të na vihet në dispozicion kopje e akteve që provon këtë fakt.
- Të na vihen në dispozicion transfertat (vlerat) dhe shkaqet e kryerjes së transfertave nga shoqëria ~~TEINDEK BVEA HOOGKAMBERSTRAAT~~ 108 N/BE/9140 TEMSE drejt "ALPHA BANK" SHA, Shqipëri për llogari të shtetases ~~Merika Musa Braga~~, e datëlindjes 07.07.1952.
- Te meren dekalime prej shtetasit ~~Paul Medeleine Ledent De Smet~~, banues ne Belgjike lidhur me faktin nese ai njihet me shtetasen ~~Merika Musa Braga~~, e datëlindjes 07.07.1952 dhe ~~Vedjola Braga~~ ne çfarë kushte dhe rrethana është njohur me to, nese ka kryer transferta për llogari të kesaj shtetase, nese po ne çfare vlere, ne çfare periudhe kohe dhe per çfare shkaku është kryer kjo transferte.
- Te kerkohet informacion prej Bankave dhe Institucioneve te ndryshme financiare qe operojne ne shtetin belg lidhur me transfertat e kryera nga shtetasi ~~Paul Medeleine Ledent De Smet~~, banues ne Belgjike per llogari te shtetaseve ~~Merika Braga~~ dhe ~~Vedjola Braga~~ apo nga keto te fundit me perfitues ~~Paul Medeleine Ledent De Smet~~.

Në kushtet kur nga të dhënat e dosjes penale kanë rezultuar disa transaksione të kryera mes shtetasve ~~Vedjola Braga~~, ~~Ervin Hatija~~, ~~Mesi Hatija~~, ~~Action Ota~~, ~~Seimin Hatija~~, ~~Frank Kurt Heinz Jullin~~ nga shteti gjerman, transaksione që varjojnë prej vlerës 190 euro deri në vlerën 1300 euro, duke vlerësuar ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm që edhe këto transaksione mund të lidheshin me transaksion me shtetin belg, objekt hetimi, organi procedues ka kërkuar ndihmën juridike prej autoriteve gjermane të drejtësisë lidhur me faktet e mëposhtme :

Ndihma juridike konsiston në :

- Të kërkohe informacion lidhur me transfertat e kryera gjatë vitit 2015 nga shtetasja ~~Merika Musa Braga~~, e datëlindjes 07.07.1952 nga Gjermania me përfitues shtetasit ~~Dimitër Hatija~~ dhe ~~Ervin Hatija~~. Nëse verifikohet ekzistenca e një transaksioni të tillë të na vihet në dispozicion praktika e plotë e transfertës së realizuar si dhe shkaku i kryerjes së kësaj transferte.

- Të kërkohet informacion lidhur me transfertat e kryera gjatë vitit 2016 nga shtetasja ~~Vedjola F. Bregu~~, e datëlindjes 03.05.1972, nga Gjermania me përfitues shtetasin ~~Ervin Hatija~~. Nëse verifikohet ekzistenca e një transaksioni të tillë të na vihet në dispozicion praktika e plotë e transfertës së realizuar si dhe shkaku i kryerjes së kësaj transferte.
- Të kërkohet informacion lidhur me transfertat e kryera gjatë vitit 2011 nga shtetasi ~~Ervin Hatija~~ nga Gjermania me përfitues shtetasen ~~Marika Musa Bregu~~, e datëlindjes 07.07.1952. Nëse verifikohet ekzistenca e një transaksioni të tillë të na vihet në dispozicion praktika e plotë e transfertës së realizuar si dhe shkaku i kryerjes së kësaj transferte.
- Të kërkohet informacion lidhur me transfertat e kryera gjatë vitit 2012 nga shtetasi Ervin Hatija nga Gjermania me përfitues shtetasen ~~Marika Musa Bregu~~, e datëlindjes 07.07.1952. Nëse verifikohet ekzistenca e një transaksioni të tillë të na vihet në dispozicion praktika e plotë e transfertës së realizuar si dhe shkaku i kryerjes së kësaj transferte.
- Të kërkohet informacion lidhur me transfertat e kryera gjatë vitit 2012 nga shtetasi ~~Artim Ceta~~ nga Gjermania me përfitues shtetasen ~~Vedjola F. Bregu~~, e datëlindjes 03.05.1972, Nëse verifikohet ekzistenca e një transaksioni të tillë të na vihet në dispozicion praktika e plotë e transfertës së realizuar si dhe shkaku i kryerjes së kësaj transferte.
- Të kërkohet informacion lidhur me transfertat e kryera gjatë vitit 2013 nga shtetasi ~~Ervin Hatija~~ në Gjermani me përfitues shtetasen ~~Marika Musa Bregu~~, e datëlindjes 07.07.1952. Nëse verifikohet ekzistenca e një transaksioni të tillë të na vihet në dispozicion praktika e plotë e transfertës së realizuar si dhe shkaku i kryerjes së kësaj transferte.
- Të kërkohet informacion lidhur me transfertat e kryera gjatë vitit 2014 nga shtetasi ~~Semir Hatija~~, ~~Vedjola Bregu~~, ~~Helmut K. J. J. J.~~, ~~Ervin Hatija~~ në Gjermani me përfitues shtetasen Marika Musa Bregu, e datëlindjes 07.07.1952. Nëse verifikohet ekzistenca e një transaksioni të tillë të na vihet në dispozicion praktika e plotë e transfertës së realizuar si dhe shkaku i kryerjes së kësaj transferte.
- Të kërkohet informacion lidhur me transfertat e kryera gjatë vitit 2014 nga shtetasi ~~Semir Hatija~~, në Gjermani me përfitues shtetasin ~~Dimitris Bregu~~. Nëse verifikohet ekzistenca e një transaksioni të tillë të na vihet në dispozicion praktika e plotë e transfertës së realizuar si dhe shkaku i kryerjes së kësaj transferte.
- Të kërkohet informacion lidhur me transfertat e kryera gjatë vitit 2014 nga shtetasi ~~Frank Kerb Heinz J. J. J.~~ në Gjermani me përfitues shtetasen ~~Vedjola Bregu~~. Nëse verifikohet ekzistenca e një transaksioni të tillë të na vihet në dispozicion praktika e plotë e transfertës së realizuar si dhe shkaku i kryerjes së kësaj transferte.

7

- Personat e kërkuara nga ana juaj kanë gjeneralitetet si më poshtë : Shtetasit Evis Hatija, i biri i Mari dhe Hanka, i datëlindjes 14.07.1986, lindur në Fier, Shqipëri, Mari Hatija, i biri i Zari dhe Limesë, i datëlindjes 07.02.1950, lindur në Sukth, Fier, Shqipëri. Merika Brega, e bija e Musa dhe e Xheza, e datëlindjes 07.07.1952, lindur dhe banuese në Ersekë, Shqipëri, Vedjola Brega, e bija e Fati dhe e Merika, e datëlindjes 19.06.1983, lindur dhe banuese në Ersekë, Shqipëri, Adrian Ceta, i biri i Qazim dhe i Fatbardha, i datëlindjes 24.10.1983, lindur në Fier, Shqipëri, Adri Hatija, i biri i Mari dhe Hanka, i datëlindjes 17.01.1991, lindur në Fier, Shqipëri dhe Saimir Hatija, i biri i Jashaj dhe i Manushaqes, i dtl 14.08.1987, lindur në Fier, Shqipëri.

Me shkresën nr.2549/3 prot, datë 20.09.2017, nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Ministrinë e Drejtësisë, ka vënë në dispozicion të organit procedues aktet e ndihmës juridike të autoriteteve shtetërore kompetente belge në përgjigje të Letërporosisë datë 09.03.2016, shoqëruar me përkthimin e këtyre akteve.

Konkretisht rezulton se shoqëria "Capa Invest" është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar themeluar më 24.05.2000 në Ruppelmande-Krefeld, themeluar nga shtetasi Ledert-De Smet Patri Madeleine Cyriel Clara, si administrator me 141 aksione dhe shtetasja Oste Carine Clara, punonjëse me 1 aksion, bashkëshortë mes tyre. Kjo shoqëri ushtronte aktivitetet në fushën e prodhimit të litarëve dhe lidhëseve. Kjo shoqëri është bashkuar e përthithur me shoqërinë "T Invest" me administrator Viktor Ledert - Desmet, e cila ka qenë shoqëria që është përthithur me aktivitetet në ofrimin e shërbimeve dhe konsulencës në fushën financiare, komerciale, fiskale, operacionale për shoqëri dhe privatë si në shtetin belge po ashtu edhe jashtë Belgjikës. Ndër të tjera kjo shoqëri në aktin e përthithjes parashikon daljen garant për palë të treta, administrator dhe aksionerë. Ajo mund tju lejojë atyre konform ligjeve në fuqi kredi dhe parapagesa. Si rrjedhojë e këtij procesi përthithje u krijua shoqëria e re me emrin "T INVEST" (BVBA HOOCKAMBERSTRAAT 108 N/BE/9140 TEMSE), për të cilën është dërguar edhe akti i themelimit e statusi i saj. Është kjo shoqëria nga e cila janë kryer transfertat në drejtim të llogarisë së shtetasës Merika Brega.

Nga verifikimi lidhur me pasuri të paluajtshme nuk kanë rezultuar pasuri të paluajtshme për personat që është kryer kërkimi në shtetin belge.

Nga kërkimi në llogaritë bankare rezulton se shtetasi Id Hatija nëpërmjet Eastern Union ka bërë dy dërgesa bankare shtetatses Adelina Metaj në shumat 134.65 USD dhe 89.14 USD, ndërsa shtetasës Umeta Arditaj një dërgesë prej 33.17 USD, të cilat sipas autoriteteve belge në pamje të parë nuk kanë lidhje me dosjen hetimore, dhe janë në gjykimin tonë në shumat të vogla.

3

Nga komunikimi me Federale Verzekeringen personat për të cilët është bërë kërkimi rezultojnë të panjohur nga sistemi i këtij insitucioni bankar/sigurime.

Nga autoritetet kompetente belge është marrë në pyetje shtetasi ~~Paul Ledent~~- De ~~Smet~~ më datë 20.09.2016, ku në mbështetje të shpjegimeve që ka dhënë ka paraqitur 5 fotografi të serave në ndërtim, një marrveshje komerciale të pa nënshkruar dhe 2 kopje të veprimeve bankare. Shtetasi ~~Paul Ledent~~- De ~~Smet~~ ka shpjeguar se njihet me shtetasen ~~Marika Bregu~~. Aktiviteti shoqërisë ~~Tëinetex bvba~~, me nr. Nipt 0472.011.007, në të cilën ky shtetas është administrator përmban ndër të tjera lëvrimin e litarëve në bujqësi për rritjen e domateve. Kryesisht aktivitetin në këtë fushë e kanë patur në Kinë, por se kualiteti i këtyre litarëve nuk plotësonte kërkesat e tregut në Europën Perëndimore. Ai shpjegon se me shtetasen ~~Marika Bregu~~ dhe vajzën e saj ~~Vedjola Bregu~~ janë njohur në një bursë bujqësore në Holandë, ku prej tyre ka mësuar se kanë patur aktivitet në fushën e rritjes së domateve në Shqipëri, aktivitet që ka ndaluar pas vdekjes së bashkëshortit të ~~Marika Bregu~~. Kanë biseduar ku shtetaset ~~Marika Bregu~~ dhe ~~Vedjola Bregu~~ kanë qenë të interesuara për të filluar një aktivitet po në këtë fushë, rritjen masive të domateve duke kërkuar blerje të prodhimit litar të shoqërisë ~~Tëinetex bvba~~, por se nuk kanë patur kapital të mjaftueshëm. Deklaruesi shpjegon se pa një mundësi të mirë për të bërë biznes, pasi fitimi sipas tij do të ishte i madh, dhe është treguar i gatshëm për të investuar një kapital fillestar për nisjen e aktivitetit të ndërtimit të një sere për prodhimin e domateve në Shqipëri. Kështu me datat 07.12.2015 dhe 07.01.2016 shoqëria ~~Tëinetex bvba~~ ka bërë dy transfertat bankare në drejtim të llogarisë së shtetasës ~~Marika Bregu~~ në ALPHA BANK në shumat 5879 Euro dhe 6992 Euro. Dhe ndërkohë puna ka filluar ku deklaruesi ka dorëzuar fotografi të serave në ndërtim e sipër dhe njëkohësisht është përpiluar një marrëveshje komerciale, e cila nuk është firmosur nga pala tjetër, ~~Marika~~ dhe ~~Vedjola~~ Bregu, e cila lidhet me një sëmundje afatgjatë të shtetasës ~~Marika Bregu~~, ku ai shpjegon se kjo shtetase ka vdekur javën e kaluar (lidhur me datën e marrjes në pyetje). Ai shpjegon se nuk ndihet i mashtruar lidhur me investimin e kryer dhe se do të vazhdojë këtë bashkëpunim me shtetasen ~~Vedjola Bregu~~, investim i cili sipas tij ka ndaluar për shkak të bllokimit të llogarive bankare nga autoriteteve gjyqësore Shqiptare. Ai deklaron se do të mundohen që me lirimin e këtyre llogarive bankare të përfundojë projekti i cili sipas tij është një mundësi e mirë biznesi. Ai shpjegon se lidhur me këtë marrveshje dhe biznes të nisur ka biseduar vetëm me shtetaset ~~Marika~~ dhe ~~Vedjola Bregu~~, dhe nuk njih të tjerë persona të përmendur në këtë hetim. Ai ka shpjeguar se ~~Tëinetex bvba~~ bën tregëti në shtete të huaj si Kina, Egjipti etj, dhe se ky rast i tregtisë në Shqipëri nuk është një rast i veçantë, duke besuar se projekti do të vazhdojë.

Në vijim nga ana jonë është administruar çertifikata e vdekjes së shtetasës ~~Marika Bregu~~ e cila ka vdekur më datë 15.09.2016 (administruar në datën 27.09.2017)

Në rrethanat e cituara me sipër, organi procedues vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjë element i veprës penale të « Pastrimi i produkteve

P

të veprës penale ose veprimtarisë kriminale », e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Transaksioni i kryer është një transaksion plotësisht i ligjshëm dhe nuk përbën asnjë indicje për faktin që shumat e lëvruara në llogarinë e shtetases ~~Merita Bregu~~ të jenë produkt i ndonjë vepre penale. Nga ana tjetër, rezulton se shtetasja ~~Merita Bregu~~ ka vdekur dhe ndaj kësaj çështje penale duhet të vendoset pushimi. Meqënëse kërkesa për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve gjermane ka qënë një kërkesë e konsumuar në kuadër të dyshimeve që transaksioni i kryer nga shteti belg ka qënë një formë e pastrimit të produkteve të veprës penale, referuar faktin që ky trasaksion që ka qënë i rregullt dhe ligjor dhe nga ana tjetër trasaksionet e kryera me shtetin gjerman janë në vlera relativisht shumë të vogla, vlerësoj se cëshja penale duhet të pushuar pavarësisht mungesës së kthimit të përgjigjes nga autoritetet gjermane të drejtësisë.

Për këto arsye, në mbështetje të nenit 328/1/b e d) dhe 329/a të Kodit të Procedurës Penale,

K Ë R K O J:

1. Pushimin e procedimit penal nr. 66, datë 20.01.2016 për veprën penale të « Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale », e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

2. Heqjen e masës së sigurimit pasuror « sekuestro preventive », mbi llogarinë bankare në lekë të shtetases ~~Merita M. Bregu~~, pranë Alpha Bank Albania sha me nr. AL3190244577432103011~~923322~~.

PROKURORI
DHORINA THEODHORI



Në mbështetje të nenit 329/a/4 të Kodit të Procedurës Penale, kërkesa iu njoftua sot më datë ___/___/___, të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës/ose

10

trashëgimtarëve të saj¹, si dhe personit që ka bërë kallëzim/ankim, të cilët kanë të drejtë të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre.

I PANDEHURI

VIKTIMA

Në mbështetje të nenit 329/a/3 të Kodit të Procedurës Penale, kërkesës iu bashkuan aktet dhe provat si më poshtë:

Kërkesa u dorëzuan në sekretarinë e gjykatës në datën 06/10/17.

DORËZUESI

MARRËSI
